REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
948/20
Datë/Datum 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.948/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I –Suharekë", kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "NBT –ING" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare" me nr. të prokurimit 624-20-5546-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Suharekë, më datën: 25.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I –Suharekë", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare" me nr. të prokurimit 624-20-5546-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Suharekë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare" me nr. të prokurimit 624-20-5546-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Suharekë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues Grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I –Suharekë", aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I –Suharekë",, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 16.11.2020 me nr. 948/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare" me nr. të prokurimit 624-20-5546-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Suharekë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 56, 59, 60, 66, 72 dhe 108/A i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 20.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit ne detaje te procedurës se tenderit si dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore te OE dhe dokumentacioni ne dispozicion te kësaj procedure te prokurimit eksperti shqyrtues jep këtë mendim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 2 - OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhiniereve të kyçur ne project -Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë (ose master ne ndertimtari) drejtimi konstruktiv, minimum 5 vite përvojë pune pas**	**Dëshmia e kërkuar dokumentare** **Dëshmia 2 - Kontrata e punës ose mareveshjet me inxhinierit, Diploma (dhe licensa per**

		diplomimit. **- Një (1) Inxhinier i Dip. i Arkitektures (ose master ne arkitekture) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.** **-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik (ose master ne hidroteknik) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.** **-Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose bachelor) me licence, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.** **-Një (1) Inxhinier i dip.i Elektros (ose master) – minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.**	**gjeodetin) e NOTERIZUAR dhe nga një CV.**

Autoriteti Kontraktues me rastin e eliminimit te grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë" ka vepruar ne kundërshtim me Kritereve te vendosura ne Dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, LPP Nenin 59, 72 dhe RROUP-në pikë 39 dhe 39.8.

1. Grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë" ne ofertën e tyre kanë prezantuar, Inxhinierin e Arkitekturës konform kërkesave te dosjes se tenderit ku kanë prezantuar Diplomë Universitare për inxhinier te Arkitekturës, Arzije Zeneli te përfunduar me dt. 10.11.2004 ; nr.276 ne Universitetin e Prishtinës, Kontratën e punës me nr. K.P.1/19 te dt. 01.02.2019 dhe CV-në.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit te operatoreve ekonomik ne ketë pikë te vendosur ne letrën standarde eliminuese kanë cekur se: *„ING e Arkitekturës, Arzije Zeneli nuk ka referenca qe ka punuar ne Ministrin e kulturës rinis dhe sportit sipas CV"* ky arsyetim i AK nuk qëndron pasi që ne dosjen e tenderit nuk ka kërkuar fare Referencë andaj eliminimi i operatorit ekonomik nga ana e AK ne këtë pikë

është i pa arsyeshëm dhe i pa bazuar dhe ne kundërshtim me vendosjen e kritereve te dosjes se tenderi, dhe pretendimi ankimor ne ketë pikë i operatorit ekonomik është i bazuar.

2. Grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë" ne ofertën e tyre kanë prezantuar, Inxhinierin e Hitroteknikës konform kërkesave te dosjes se tenderit ku kanë prezantuar Diplomë Universitare për inxhinier te Hidroteknik Zarife Sallhu te përfunduar me dt.23.06.2006 nr.439 në Universitetin e Prishtinës, Kontratën e punës me nr. K.P.5/18 te dt.13.03.2018 dhe CV-në.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit te operatoreve ekonomik ne kete pikë të vendosur ne letrën standarde eliminuese kanë cekur se: *„ING e Hidroteknikës, Zarife Sallhu, kontrata e punës e lidhur me dt. 13.03.2018 nuk korrespondon me CV e lëshuar pasi që CV është data qe ka filluar punën me 01.03.2016"* nuk është i arsyeshëm pasi që ne këto raste autoritetet kontraktuese është dashur qe te kërkojnë sqarime shtesë ne bazë LPP Nenit 72 dhe RROUP pikës 39 dhe pikës 39.8 dhe te konstatoj drejt dhe saktë vlerësimin e ofertës.

Pika 39.8 e RROUP , Tabela njoftuese ne rastet e kërkimit te sqarimeve.

CV-ja e dorëzuar nuk përmbanë informatat e kërkuara, AK nuk mundet te vendos.	Mund te kërkohën informata sqaruese	Neni 69

Andaj operatori ekonomik ankues ka dorëzuar CV dhe Kontratat dhe për çdo pa qartësi AK është dashur qe te kërkoj sqarime nga ana e OE dhe te vlerësoj drejt pretendimin dhe arsyetimin e eliminimit te operatorit ekonomik lidhur me këtë pikë, dhe pretendimi ankimor ne ketë pikë i operatorit ekonomik është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke pasur parasysh sqarimet e lartcekura dhe bazuar ne zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe dokumentacionit te ofertave dhe vlerësimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie te kontratës dhe procedura te kthehet ne Ri-vlerësim.

Autoriteti kontraktues duhet te ketë parasysh zbatimin e Neneve 1, 6, 7, 59, 72 të LPP-së, RROUP pikën 39 dhe 39.8 si dhe Kriteret e Vendosura ne Dosjen e Tenderit, dhe Nenin 60 te LPP-së me rastin e rivlerësimit te aktivitetit te prokurimit.

Autoriteti Kontraktues me datë 24.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Ju njoftoj se AK-Suhareke nuk pajtohet me mendimin e ekspertit te ekspertizës 948/20.

Ak-Suharek Sqaron:

Ak ju sqaron se në oferten e dorëzuar në platëformen elektronike e-prokurimi, në dokumentacionin lidhu me inxhinierin e hidroteknikes keni ofruar deshmi te cilat nuk korespondojnë njera me tjeteren, në dosje keni ofru një kontartë punë me Nr. K.P. : 5/18 ndërmjet ING Hidroteknikes Zarife Sallahu dhe OE Top Projekt të hartuar me date 13.03.2018 në kohëzgjatje deri më 31.12.2020.

Ndërsa Referenca e lëshuar nga OE Top Projekt për të njejtin inxhinier- Zarife Sallahu, Referenca Nr. 03/2018, e datës 14.01.2017, me të cilen Referenc Thotë; Citim "vërteton se Zarife Sallahu Ing e diplomuar e ndertimtarise- Drejtimi Hidroteknik, është e angazhuar nga kompanija jonë NNSH Top Projekt prej datës 01.03.206 deri më 31.12.2017".

Në CV-inë e prezantuar nga ING I Hidroteknikes, te eksperienca profesionale pershkuan se e njejta ne është punësuar te NNSH Top Projekt nga data 01.03.2016- vazhdon. Nga kjo shihet qartë se Kontarta e Punës është në te kunderten e deklaruar në Cv. Poashtu Referenca e eshte në kundershtim me Kontraten e poashtu edhe me CV, data e references nuk perputhet me afatin e punes(referenca date 04.01.2017, per periudhe 01.03.206 deri 31.12.2017, per punen e pa kryer leshohet reference) me qka kjo vihet ne dilem validiteti I ketyre dokumenteve, ku objktivisht keto dokumente janë të pa verifikushme edhe sikur te kerkohet sqarim, per faktin e ktyre diskrepancave te paraqitura në këto dokumente.

Pretendimi për Ing e Arkitektures Arzije Zeneli, në CV- e prezentura ne dosje, te eksperienca profesionale prezanton se qe nga data 01.08.2013 deri 31.12.2018 punon në Ministrinë e Kultures, Rinisë dhe Sportit. Në kërkesen për ri-shqyrtim ju keni sjell dëshmi- Referencë nga Ministrinë e Kultures, Rinisë dhe Sporti, ku thueht se Arzije Zeneli është e punësuar në Institutin e Kosovës për mbrjtjen e Monumenteve – IKMM që nga viti 2009. Ndersa në kontratën e prezantuar nga ju ne dosje keni prezantuar kontratë N.R K.P.: 01/2019 me date 01.02.2019 ndërmjet ING Arzije Zenli dhe OE Top Projekt, me marrëdhenie pune nga date 01.02.2019 deri 31.12.2020, me orarë prej 40 orë në javë. Ak- ju sqaron se Referenca në fjal bie në kundershtim me CV-in e prezantuar në dosje, ku ne cv prezanton se ka punuar nga data 01.08.2013 deri 31.12.2018, ndersa referenca thotë qe punon nga viti 2009 e që nenkupton qe punon ende. Duke pasur parasysh keto kunderthenie te paraqitura nga ju, verehet qe ka kunderthenie të dokumentave ndermjet njera tjetres dhe dihet qe nje person nuk mundet te ketë dy marrëdhenie pune me orarë të plotë sipas dispozitave ligjore të aplikushëm ne R. Kosovës.

Operatori Ekonomik me datë 23.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI", se AK me rastin e eliminimit te grupit te operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë" ka vepruar ne kundërshtim me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, LPP Nenin 59, 72 dhe RROUP-në pikë 39 dhe 39.8.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë" ne ofertën e tyre kanë prezantuar, Inxhinierin e Arkitekturës konform kërkesave te dosjes se tenderit ku kanë prezantuar Diplomë Universitare për inxhinier te Arkitekturës, Arzije Zeneli te përfunduar me dt. 10.11.2004 ; nr.276 ne Universitetin e Prishtinës, Kontratën e punës me nr. K.P.1/19 te dt. 01.02.2019 dhe CV-në.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit te operatoreve ekonomik në këtë pikë të vendosur në letrën standarde eliminuese kanë cekur se: *„ING e Arkitekturës, Arzije Zeneli nuk ka referenca qe ka punuar ne Ministrin e kulturës rinis dhe sportit sipas CV"* ky arsyetim i AK nuk qëndron pasi që ne dosjen e tenderit nuk ka kërkuar fare Referencë andaj eliminimi i operatorit ekonomik nga ana e AK ne këtë pikë është i pa arsyeshëm dhe i pa bazuar dhe ne kundërshtim me vendosjen e kritereve te dosjes se tenderi. Pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Sa i përket arsyes tjetër të eliminimimit të grupit të operatorëve ekonomik "EKO TERM" SH.P.K & N.N.SH "TOP PROJEKT"& "LIRIM BUJARI" B.I – Suharekë", Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në ofertën e tyre kanë prezantuar, Inxhinierin e Hitroteknikës konform kërkesave te dosjes se tenderit ku kanë prezantuar Diplomë Universitare për inxhinier të Hidroteknik Zarife Sallhu të përfunduar me dt.23.06.2006 nr.439 në Universitetin e Prishtinës, Kontratën e punës me nr. K.P.5/18 te dt.13.03.2018 dhe CV-në. Arsyetimi i autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit të operatorëve ekonomik në këtë pikë të vendosur ne letrën standarde eliminuese kanë cekur se: *„ING e Hidroteknikës, Zarife Sallhu,*

kontrata e punës e lidhur me dt. 13.03.2018 nuk korrespondon me CV e lëshuar pasi që CV është data qe ka filluar punën me 01.03.2016" nuk është i arsyeshëm pasi që ne këto raste autoritetet kontraktuese është dashur qe te kërkojnë sqarime shtesë në bazë LPP Nenit 72 dhe RROUP pikës 39 dhe pikës 39.8 dhe të konstatoj drejt dhe saktë vlerësimin e ofertës.

Pika 39.8 e RROUP , Tabela njoftuese ne rastet e kërkimit te sqarimeve.

CV-ja e dorëzuar nuk përmbanë informatat e kërkuara, AK nuk mundet te vendos.	Mund te kërkohën informata sqaruese	Neni 69

Andaj, operatori ekonomik ankues ka dorëzuar CV dhe Kontratat dhe për çdo pa qartësi AK është dashur që të kërkoj sqarime nga ana e OE dhe te vlerësoj drejt pretendimin dhe arsyetimin e eliminimit të operatorit ekonomik lidhur me këtë pikë, dhe pretendimi ankimor në këtë pikë i operatorit ekonomik është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit është duke shmangur nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Po ashtu, AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që të ketë parasysh nenin 1, 6, 7, 59 dhe 72 të LPP-së, pikën 39 dhe 39.8 të RROUP, si dhe kriteret e vendosura në dosjen e tenderit dhe nenin 60 të LPP-së me rastin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Suharekë;

1x1 OE - "Eko Term" SH.P.K & N.N.SH "Top Projekt"& "Lirim Bujari";

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.